



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 400-5778/15
Kaçanik, 27.02.2015

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 61 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 4 të Ligjit nr.05/L-001.- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, të nenit 5 lidhur me nenin 17 alinea 2 e Rregullores 01Nr. 16- 27192/12-Për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, të neneve 2-4 të Rregullores 01Nr. 16-18737/13 -Për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 16-27192/12 –Për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, si dhe nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2015, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR SUBVENCIONE DHE TRANSFERE SIPAS BUXHETIT TË
KOMUNËS PËR NË VITIN 2015.

1. Me këtë Vendim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2015, i paraparë për Subvencione dhe Transferë të programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit në shumë prej **65,000** euro, do të financon këto projekte dhe aktivitete:

- Ndarja e 50 bursave për studime universitare shuma prej **20,000** euro ;
- Ndarja e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të varrimit ndaj qytetarëve në shumë prej 150 euro për person të vdekur në shumë të përgjithshme prej **25,000** euro;
- Mjete për kompaninë rajonale të ujit KRUK “Bifurkacioni” në shumë prej **3,000** euro ;
- Mjete për Organizatën Komunale të Veteranëve të Luftës së UÇK-së për mbulimin e shpenzimeve në shumë të përgjithshme prej **4,000** euro ;
- Mjete për Organizatën Komunale të Invalidëve të Luftës së UÇK-së për mbulimin e shpenzimeve në shumë të përgjithshme prej **3,500** euro ; dhe
- Mjete me vendime të veçanta individuale të Kryetarit të Komunës deri në 1,000 euro për raste sociale, shëndetësore, emergjente dhe raste tjera të cilat vlerësohen si të domosdoshme në shumë totale prej **9,500** euro.

2. Për realizimin e këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton pas miratimit në Kuvendin Komunal.

3. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi